



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 13.11.2019)

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:45 dhe mbaroi në orën 13:10.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Maksim Qoku* (zëvendëskryetar)
3. *Medi Bici* (anëtar)
4. *Fatmira Luli* (anëtare)
5. *Brunilda Kadi* (anëtare)
6. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
7. *Illir Toska* (anëtar)
8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtar)
10. *Marçela Shehu* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Erjon Muharremaj.

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
3. *Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
4. *Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
5. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
6. *Klodian Rado, EURALIUS.*
7. *Gregor Borkowski, EURALIUS.*
8. *Artan Spahiu, Kryetar i Komisionit të Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e Zbatimit të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”*
9. *Valbona Paja, USAID.*
10. *Përfaqësues të medias.*

RENDI I DITËS:

1. “Për fillimin e procedurës së përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë të kandidatëve, nga radhët e juristëve të spikatur (jogjyqtarë), për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr.108, datë 09.07.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”;
2. “Për fillimin e procedurës së përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë të kandidatëve, nga radhët e juristëve të spikatur (jogjyqtarë), për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr.109, datë 09.07.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”;
3. “Për fillimin e procedurës së përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë të kandidatëve, nga radhët e juristëve të spikatur (jogjyqtarë), për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr.110, datë 09.07.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”;

4. “Për fillimin e procedurës së përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë të kandidatëve, nga radhët e juristëve të spikatur (jogjyqtarë), për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr.172, datë 11.09.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”;

Naureda Llagami: Atëherë, përshëndetje!

Siç jeni në dijeni nga njoftimi, sot do zhvillojmë mbledhjen e radhës të Këshillit të Lartë Gjyqësor, mbledhjen e datës 13 nëntor të vitit 2019.

Janë të pranishëm të gjithë anëtarët e Këshillit, përveç zotit Erjon Muharremaj, i cili është në një aktivitet ku përfaqëson Këshillin e Lartë Gjyqësor jashtë vendit.

Në vijim të mbledhjes së djeshme, sot kemi katër projektvendime për të miratuar në rendin e ditës.

Sikurse jeni në dijeni, duke përfituar nga prezenca e medias, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka punuar dhe po punon intensivisht për funksionalizimin e Gjykatës së Lartë dhe përfundim brenda një afati të arsyeshëm të të gjithë procedurave ligjore të përzgjedhjes së kandidatëve të kësaj gjykate.

Në muajt e mëparshëm Këshilli ka shpallur katër vende vakante për në Gjykatën e Lartë nga radhët e juristëve të spikatur.

Dëshiroj t’ju informoj që për këto katër vendet vakante, kanë aplikuar 23 kandidatë, prej të cilëve 4 kandidatë janë tërhequr nga kandidimi, 11 kandidatë, me vendim të Këshillit janë skualifikuar dhe përjashtuar nga procedura e emërimit për shkak të mosplotësimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit. Kështu, procedura vazhdon për 8 kandidatët të mbetur në konkurrim.

Dje, Këshilli, me vendimmarrjen e tij, ka përfunduar procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për 3 nga këto 8 kandidatët. Këto kandidatë i janë nënshtruar një verifikimi të plotë dhe të thellë të figurës dhe të pasurisë. Konkretisht Këshilli vendosi: të kualifikojë për të vazhduar garën dhe konkurrimin si kandidat në Gjykatën e Lartë z. {...}, z.{...} dhe z. {...}.

Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, Këshilli sot do të marri një vendimmarrje tjetër e cila ka të bëjë me përzgjedhjen e këtyre kandidatëve si kandidatë në Gjykatën e Lartë. Për të realizuar përzgjedhjen, Këshilli duhet të bëjë vlerësimin dhe pikëzimin e këtyre

kandidatëve. Vlerësimi dhe pikëzimi do të bëhet në bazë të rregullores, kriterëve të përcaktuara në rregulloren e Këshillit nr. 102 të vitit 2019, ku konsiston vlerësim lidhur me “Meritat profesionale”, “Meritat morale dhe etike”, “Meritat organizative dhe menaxheriale”. Ndërkohë, dëshiroj të theksoj se procedura e verifikimit për kriteret ligjore vazhdon ende për 5 kandidatët e tjerë dhe është e pritshme që procesi të përfundojë shumë shpejt për këto 5 kandidatët.

Tashmë për të vazhduar lidhur me relativimin e projekt-aktit ia jap fjalën zotit Ilir Toska, kryetar i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

Ilir Toska: Faleminderit!

Atëherë, në vijim të fjalës suaj Kryetare, ju bëtë një ekspozitë të situatës faktike dhe ligjore në këtë moment. Këshilli në këtë rast është i detyruar të vijojë me procedurën e përzgjedhjes për emërim të kandidatëve që tashmë janë kualifikuar, por edhe të atyre që do të kualifikohen në ditët në vijim.

Faza e dytë e përzgjedhjes ka të bëjë me vlerësimin, pikëzimin dhe renditjen e kandidatëve, referuar kriterëve dhe treguesve të përcaktuar në vendimin e Këshillit nr. 102, datë 05.07.2019. Referuar këtij vendimi, në kushtet kur janë kualifikuar 3 kandidatë tashmë, të cilët kandidojnë për katër pozicione të lira, të shpallura me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pra me vendimet nr. 108, 109 dhe 110, të datës 9 korrik 2019, si dhe me vendimin nr. 172, datë 11 shtator 2019, Këshilli do duhet të përcaktojë një raport për secilën procedurë përzgjedhjeje, sipas pozicioneve të lira të shpallura.

Në relacionin që është përgatitur dhe i është shpërndarë anëtarëve, janë bërë referencat në dispozitat përkatëse të vendimit nr. 102, datë 05.07.2019, referuar të cilave Këshilli sot ka detyrimin të vijojë me deklarinimin për fillimin e procedurës së përzgjedhjes për emërim si dhe me caktimin e raportit për secilën nga procedurat përzgjedhëse, sipas pozicioneve respektive të lira, të shpallura me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Pika e parë e disponimit të Këshillit është për fillimin e procedurës së përzgjedhjes për secilin pozicion të lirë të shpallur. Ndërsa pika e dytë ka të bëjë me caktimin e raportit, i cili sipas vendimit të Këshillit, do duhet të përzgjidhet përmes shortit.

Sa i përket shortit, është propozuar që të zhvillohet duke futur në dy enë qelqi të tejudkshme emrat e katër anëtarëve të Komisionit (3 anëtarëve të përhershëm dhe një

anëtari zëvendësues, meqenëse janë katër procedura përzgjedhëse), ndërsa në enën tjetër numrat e vendimeve respektive për pozicionet e lira të shpallura (pra nr. 108, nr. 109 dhe nr. 110 të datës 9 korrik 2019 dhe nr. 172 të datës 11 shtator 2019). Në njëërën enë duhet të përzgjidhet emri i një anëtari, pastaj do të përzgjidhet një numër që ka të bëjë me pozicionin e lirë, që respektivisht është edhe procedura përzgjedhëse që do duhet të ndiqet për të gjithë kandidatët që konkurrojnë për atë pozicion. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

Përpara se të kalojmë në aplikimin e procedurës së shortit, kemi ndonjë sqarim apo ndonjë diskutim lidhur me projekt-aktet e propozuara nga Komisioni përkatës?

Po, zonja Ukperaj!

Brikena Ukperaj: Faleminderit, zonja Kryetare!

Atëherë, propozimi im lidhet konkretisht me projektvendimin e numërtuar i katërti në listën e çështjeve të paraqitura në rendin e ditës dhe ka të bëjë me faktin që aktualisht, sipas rregullores me vendimin nr. 102, ne kemi miratuar që në rastet kur për pozicione të veçanta ka kandidatë të cilët kualifikohen më shpejt se të tjerët, nuk ka ndonjë pengesë që paralelisht të vazhdojë edhe procedura e verifikimit të kandidatëve të tjerë që nuk kanë kaluar edhe procedura e vlerësimit, pikëzimit të kandidatit që tashmë është kualifikuar.

Aktualisht kemi dy pozicione të lira të shpallura për juristë të spikatur në fushën e së drejtës civile dhe për shkaqe procedurale, duke qenë se i njëjti kandidat që është zoti {...}, kandidon edhe për pozicionin e shpallur me vendimin nr. 109 edhe për pozicionin e shpallur me vendimin nr. 172, në qoftë se do të zbatonim rregulloren dhe do të caktohej dhe do të kishim relatorë të ndryshëm për secilin pozicion, mund të kishim një eventualitet të mundshëm që vlerësimi i pikëve dhe i kriterëve për këtë kandidat të bëhej njëkohësisht nga dy relatorë të ndryshëm, në eventualitet mund të kishim edhe rezultate të ndryshme në pikëzimit. Prandaj unë do të propozoja që ose i) të mos vazhdonim sot me caktimin e relatorit për pozicionin e katërt, për arsye sepse zoti {...} kandidon edhe për pozicionin 2 edhe për pozicionin 4 ose ii) në projektvendimin që ka të bëjë me fillimin e procedurës së përzgjedhjes nga radhët e juristëve të spikatur, të shpallur me vendimin nr. 172, të shtohet edhe një pikë tjetër ku të sqarohet që: “Vendimi i vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatit z. {...}, i marrë në kuadër të procedurës së përzgjedhjes për emërim, për

pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 109, datë 09.07.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, është i vlefshëm edhe për procedurën e përzgjedhjes për emërim, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 172, datë 11.09.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.”

Sqaroj, është i nevojshëm ky shtim në projektvendim sepse kemi të njëjtin kandidat për të njëjtin pozicion të lirë të shpallur, që është specialist në fushën e së drejtës civile. Nëse do të ishte në një fushë tjetër të së drejtës administrative ose penale, sigurisht që do të kishim kritere të ndryshme vlerësimi, në varësi të dokumenteve të paraqitura nga kandidati. Për të shmangur këtë vlerësimin e ndryshëm, propozoj që vlerësimi i zotit {...} të bëhet vetëm nga një relator dhe nga relatori që do të caktohet për vendimin më të parë që ne kemi marrë në radhë të shpalljes së vendeve vakante dhe pozicioneve të lira. Do të thotë që relatori i pozicionit të lirë, të shpallur me vendimin nr. 172, edhe mund të caktohet, por nuk është e nevojshme që të fillojë edhe ai paralelisht procedurën e vlerësimit, ndërkohë që do ketë një relator që për të njëjtin kandidat është përcaktuar sipas vendimit nr. 109. Nuk e di nëse jam e qartë. Por besoj se... Ky është propozimi.

Naureda Llagami: Faleminderit, zonja Ukperaj!

Atëherë, unë propozoj që të hedhim...

Po, zoti Toska!

Ilir Toska: Atëherë, edhe unë jam dakord me propozimin që bëri zonja Ukperaj, që të shtohet një pikë 3) tek projektvendimi për pozicionin e katërt që është për pozicionin në fushën e së drejtës civile që është shpallur më vonë, më datë 11 shtator 2019 dhe në këtë mënyrë shpallim dublimin e procedurës së vlerësimit dhe pikëzimit për kandidatin {...}. Faleminderit!

Naureda Llagami: Atëherë, përpara se të kalojmë në procedurën e shortit, atëherë kalojmë në votimin e propozimit të bërë nga zonja Ukperaj dhe pranuar edhe nga Komisioni përkatës.

Brunilda Kadi: ... pse duhet ta miratojmë tani ne?! Kur të shkojmë tek pika 4, e bënim këtë. Se s'ka kuptim.

Mirë pra, edhe ajo që propozoi zonja Ukperaj, do ketë përparësi ajo që do bëhet në fillim dhe mua më duket si... s'ka logjikë që ta marrim tani vendimin. I marrim me radhë 1, 2, 3 dhe kur të vijmë tek 4, votojmë...

Naureda Llagami: Në qoftë se ju e gjykoni... Po! Dakord!

Mirë, dakord! Fillojmë me projekt-aktin e parë dhe të fillojmë me procedurat e hedhjes së shortit, sipas mënyrës se si e shpjegoi kryetari i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

Administrata të mundësojë zhvillimin e shortit.

Elis Kuçi: Atëherë në enën e parë do vihen anëtarët e Komisionit dhe anëtari zëvendësues. Zoti Ilir Toska – Kryetar i Komisionit; Zonja Marçela Shehu; Zoti Alban Toro; dhe anëtari zëvendësues zoti Dritan Hallunaj.

Në enën tjetër do vendosen numrat e vendimeve, konkretisht: Vendimi i KLGJ-së nr. 108, datë 09.07.2019; Vendimi 109, datë 09.07.2019; Vendimi 110, datë 09.07.2019; dhe Vendimi 172, datë 11.09.2019.

Si fillim do zgjedhim një nga anëtarët.

(Përzgjidhet anëtari i parë.)

Zonja Marçela Shehu.

(Përzgjidhet nr. i vendimit.)

Zonja Shehu do jetë relatore për pozicionin e lirë të shpallur për në Gjykatën e Lartë me vendimin nr. 109, datë 09.07.2019.

(Përzgjidhet anëtari i dytë.)

Zoti Ilir Toska.

(Përzgjidhet nr. i vendimit.)

Zoti Toska do jetë relator për pozicionin e lirë të shpallur për në Gjykatën e Lartë me vendimin nr. 110, datë 09.07.2019.

(Përzgjidhet anëtari i tretë.)

Zoti Dritan Hallunaj.

(Përzgjidhet nr. i vendimit.)

Zoti Hallunaj do jetë relator për pozicionin e lirë të shpallur për në Gjykatën e Lartë me vendimin nr. 172, datë 11.09.2019.

(Përzgjidhet anëtari i katërt dhe i fundit në enën e qelqit.)

Zoti Alban Toro.

(Përzgjidhet nr. i vendimit të mbetur në enën e qelqit.)

Zoti Alban Toro do jetë relator për pozicionin e lirë të shpallur për në Gjykatën e Lartë me vendimin nr. 108, datë 09.07.2019.

Mbaroi procedura.

Naureda Llagami: 1. Atëherë, në vijim të procedurës së shortit - po shpallim vendimin – Këshilli vendosi: Fillimin e procedurës së përzgjedhjes për emërimin në Gjykatën e Lartë të kandidatëve, nga radhët e juristëve të spikatur (jogjyqtarë), në pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 109, datë 09.07.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor. 2. Caktimin e zonjës Marçela Shehu si relatore për procedurën e përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë të kandidatëve, nga radhët e juristëve të spikatur (jogjyqtarë), për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 109, datë 09.07.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Jemi dakord me projektvendimin? Votim.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Fillimin e procedurës së përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë të kandidatëve, nga radhët e juristëve të spikatur (jogjyqtarë), për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 108, datë 09.07.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor. 2. Caktimin e z. Alban Toro si relator për procedurën e përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë të kandidatëve, nga radhët e juristëve të spikatur (jogjyqtarë), për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 108, datë 09.07.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë në votim projektvendimin?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Projektvendimi i radhës. Këshilli vendosi: 1. Fillimin e procedurës së përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë të kandidatëve, nga radhët e juristëve të spikatur (jogjyqtarë), për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 110, datë 09.07.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor. 2. Caktimin e z. Ilir Toska si relator për procedurën e përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë të kandidatëve, nga radhët e juristëve të spikatur (jogjyqtarë), për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 110, datë 09.07.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë në votim?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, lidhur me vendimin e radhës të projektpropozuar nga Këshilli, këtu do reflektojmë edhe propozimin e bërë nga zonja Ukperaj dhe pranuar nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Unë po e lexoj projektvendimin me gjithë propozimin e bërë. Pra Këshilli vendosi: 1. Fillimin e procedurës së përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë të kandidatëve, nga radhët e juristëve të spikatur (jogjyqtarë), për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 172, datë 11.09.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor. 2. Caktimin e z. Dritan Hallunaj si relator për procedurën e përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë të kandidatëve, nga radhët e juristëve të spikatur (jogjyqtarë), për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 172, datë 11.09.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor. 3. Vendimi i vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatit z. {...} i marrë në kuadër të procedurës së përzgjedhjes për emërim për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 109, datë 09.07.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor është i vlefshëm edhe për procedurën e përzgjedhjes për emërim për pozicionin e lire të shpallur me vendimin nr. 172, datë 11.09.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Brunilda Kadi: Kam diçka përpara se të hidhet në votim.

A mund të ndodhë teorikisht që të ecë më shpejt procedura tek vendimi nr. 172? Sepse ideja/propozimi ishte që verifikimi do vlejë edhe për këtë procedurë, por pikëzimi, mund të ndodhë që pikëzimi tek 4 mund të ecë më shpejt se tek vendimi 109. Mund të ndodhë teorikisht? Sepse mund të ecë më shpejt procedura ku është zoti Hallunaj relator. Si ishte propozimi? Kush mbaron më shpejt, të vlejë për tjetrin, apo jo? Sqaroje, se ngaqë... se mund të ndodhë teorikisht ndryshe.

Ilir Toska: Teorikisht mund të ndodhë por procedurat e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për vendimin nr. 172, të kandidatëve që kanë aplikuar sipas vendimit 172, ka filluar 2 muaj më pas, kështu që teorikisht duhet të jetë më me vonesë përfundimi i fazës së parë për këtë pozicion. Prandaj teorikisht është më shpejt pozicioni i lirë me vendimin 109, që mund të eci. Faleminderit!

Brunilda Kadi: ... ai që do jetë më i hershëm të ketë vlerë për atë që është i mëpasshëm.

Jam shumë dakord që s'mund të ketë dy relatorë për të njëjtin. Por ta vejmë tek ajo që propozohet. Kush të mbarojë më përpara, të ketë vlerë për procedurën që vazhdon më tutje, meqenëse teorikisht ekziston mundësia që...

(Disa nga anëtarët flasin pa ndezur mikrofonat.)

Okej! Meqenëse ju e keni analizuar dhe ju del që nuk del asnjëherë kjo mundësi.

Naureda Llagami: Atëherë, e kishim në fazën e hedhjes në votim të projektpropozimit, bashkë me ndryshimin. Kalojmë në votim.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, nëse nuk kemi ndonjë gjë tjetër, mbledhja konsiderohet e mbyllur për sot. Faleminderit! Mirupafshim!

* * *

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor